

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.1.1 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet

Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë

Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

1.1.2 Punime prishje

Keto punime përfshijnë prishje e suvave të demtuara deri në gjetjen e shtresës së qendrueshme të suvave, pastrimin e llustrës, prishjet e duhura mureve për realizimin e dritareve e dyerve, Mbushjen e hapësirave në muret perimetrale me mur tulle 25 cm, spostimin e mbetjeve inerte që rezultojnë nga prishjet si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë fund plotësisht punimeve të prishjes duke përfshirë edhe përdorimin e skelerisë dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve.

1.1 Rifiniturat e mureve

1.3.1 Suvatimi i brendshëm

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucimi i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaç bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m-1 : 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

1.3.3 Patinimi

Patinaturë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së

lartë, mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.

1.3.3 Parapeti

Parapeti realizohet duke bere furnizimin e pllakave te granilit b/a te parapergatitura edhe vendosjen e tyre ne veper duke respektuar kushtet e sigurise ne pune.

1.3.8 Lyerje me bojë plastike në rikonstruksion

Lyerje me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme
Proçesi i lyerjes me bojë plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet.

Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes.

Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2- Paralyerja e sipërfaqes së brendshme të pastruar.

Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m² sipërfaqe.

3- Lyerja me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

1.2 Dyer

1.2.1 Dyer të brendshme

Dyer te brendshme druri

Kanatet hapëse të dyerve të bëra me dru te stazhionuar të fortë të siguruar nga një bravë sigurie. Trashësia totale e dyerve do të jetë 5,5 cm minimalisht dhe do te kene konfiguracionin e thjeshte me dy zemra druri ne dy pjeset(lart dhe poshte)

Një model i zërit të propozuar, duhet ti jepet Supervizorit për aprovim paraprak.

1.2.2 Hidroizolimi

Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqë të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuara me shtresë të parë bituminoze si veshje e parë. Dbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fibër minerale & karton katrama', secila me trashësi min. 3 mm, e ngjitur me flakë, membrana të vendosura në këndet e duhura mbi njëra) tjetrën, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar se mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë 12 cm. hidroizolimi mund te behet edhe me dy shtresa guana e cila aplikohet me lyerje sipas udhezimeve te perdoruesit..Mbrojtja e membranës izoluese me plan vertikal ose të pjerrët do të realizohet me shtresë llaç ose plaka çimentoje me trashësi 2cm (tipi I llaçit 1:2), pllakat ose shtresa e llaçit do të realizohet në formë kuadrati 2x2 m, me fuga nga 2 cm, të cilat do të mbushen me bitum sipas kërkesave të dhëna në vizatime.

1.2.3 Instalimet elektrike

Instalimi I eelementeve elektrik si prizat,celesat ndricuesit etj duhet bere ne kushtet e sigurise se punes duke shkeputur energjine elektrike gjate procesit te punes. Keto aksesori blihen me karakteristikat qe jane theksuar ne projekt preventivin.